



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 5 Maj 2021

Nr: 55

VENDIM

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 27 TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ-së NR. 66, QARKU BERAT, NR. 28 TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ-së NR. 38, QARKU TIRANË, NR. 29 TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ-së NR. 2, QARKU SHKODËR, NR. 30 TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ-së NR. 20, QARKU DURRËS DHE NR. 31 TË ANËTARËVE DHE SEKRETARIT TË KZAZ-së NR. 21, QARKU DURRËS”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 05.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Kryesues
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES 1: Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 66, qarku Berat;
ANKUES 2: Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë;
ANKUES 3: Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër;
ANKUES 4: Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës;
ANKUES 5: Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës.

OBJEKTI: 1- Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 27, të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 66, qarku Berat, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 306, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 66, qarku Berat”.



2- Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 28, të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 318, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë”.

3- Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 29, të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 313, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër”.

4- Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 30, të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 307, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës”.

5- Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 31, të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 308, datë 26.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjes administrative për shkelje të Kodit Zgjedhor nga anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës”.

BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “c”, 118, 119, pika 5, 122, 124, 132, 133, 143 pika 1, shkronja “c”, 171 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; neni 65, shkronja “ç”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 25.04.2021, në 12 zonat zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Për 92 Komisione të Administrimit të Zonës Zgjedhore (KZAZ) procesi i numërimit ka filluar rreth orës 22:00 të datës 25.04.2021. Neni 119, pika 5, përcakton se *procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuarra të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit.*
2. Në orën 22:00 të datës 26 Prill 2021, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka konstatuar se KZAZ nr. 66, qarku Berat, kishte numëruar fletë votimi për 19 Qendra Votimi (QV) nga 45 në total. Kjo shifër e përkthyer në përqindje përbën 42.22%.
Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) konstatoi se KZAZ-ja nr. 66, qarku Berat ka shkelur nenin 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor që përcakton se *tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.*
Në vendimin e tij nr. 306, datë 26.04.2021, KSHZ, bazuar në nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, vendosi sanksionin administrativ gjobë, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë për secilin anëtar dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 66, qarku Berat.
3. Në orën 22:00, të datës 26 Prill 2021, administrata e KQZ ka konstatuar gjithashtu se KZAZ nr. 38, qarku Tiranë, kishte numëruar fletë votimi për 22 QV nga 50 në total. Kjo shifër e përkthyer në përqindje përbën 44%.
Për këtë arsye, KSHZ konstatoi se KZAZ-ja nr. 38, qarku Tiranë ka shkelur nenin 122, pika 1 të Kodit Zgjedhor që përcakton se *Tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.*
Në vendimin e tij nr. 318, datë 26.04.2021, KSHZ, bazuar në nenin 171, pika 1 të Kodit Zgjedhor, vendosi sanksion administrativ gjobë, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë për secilin anëtar dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë.
4. Në orën 22:00 të datës 26 Prill 2021, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka konstatuar se KZAZ nr. 2, qarku Shkodër, kishte numëruar fletë votimi për 42 Qendra Votimi (QV) nga 109 në total. Kjo shifër e përkthyer në përqindje përbën 38.53%.

Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) konstatoi se KZAZ-ja nr. 2, qarku Shkodër ka shkelur nenin 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor që përcakton se *tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.*

Në vendimin e tij nr. 313, datë 26.04.2021, KSHZ, bazuar në nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, vendosi sanksionin administrativ gjorbë, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë për secilin anëtar dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër.

5. Në orën 22:00 të datës 26 Prill 2021, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka konstatuar se KZAZ nr. 20, qarku Durrës, kishte numëruar fletë votimi për 28 Qendra Votimi (QV) nga 92 në total. Kjo shifër e përkthyer në përqindje përbën 30.43%.

Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) konstatoi se KZAZ-ja nr. 20, qarku Durrës ka shkelur nenin 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor që përcakton se *tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.*

Në vendimin e tij nr. 307, datë 26.04.2021, KSHZ, bazuar në nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, vendosi sanksionin administrativ gjorbë, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë për secilin anëtar dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës.

6. Në orën 22:00 të datës 26 Prill 2021, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ka konstatuar se KZAZ nr. 21, qarku Durrës, kishte numëruar fletë votimi për 52 Qendra Votimi (QV) nga 108 në total. Kjo shifër e përkthyer në përqindje përbën 48.15%.

Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) konstatoi se KZAZ-ja nr. 66, qarku Berat ka shkelur nenin 122, pika 1, të Kodit Zgjedhor që përcakton se *tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22:00 e ditës së nesërme të votimit.*

Në vendimin e tij nr. 308, datë 26.04.2021, KSHZ, bazuar në nenin 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, vendosi sanksionin administrativ gjorbë, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë për secilin anëtar dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës.

7. Kundër vendimit nr. 306, datë 26.04.2021 të KSHZ-së kanë depozituar kërkesë ankimore anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 66, qarku Berat. Ankuesit parashtrojnë vonesat kanë qenë për shkaqe të arsyeshme konkretisht:

- Printeri ka pasur defekt i cili ka zgjatur ne rreth një orë;
- Kryetari i KZAZ ka shfaqur probleme shëndetësore dhe është dashur zëvendësimi i tij (bashkëlidhur ankimit janë edhe vendimet e Komisionerit për lirim nga detyra të Kryetarit dhe emërimin e Kryetarit të ri).
- Ndikim të konsiderueshëm ka pasur edhe efekti stresues nga ngjarjet e mësipërme dhe nga orari i punës i tejzgjatur.

Përfundimisht, anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 66, qarku Berat, kërkojnë shfuqizimin e vendimit nr. 306, datë 26.04.2021 të KSHZ-së.

8. Kundër vendimit nr. 318, datë 26.04.2021 të KSHZ kanë depozituar kërkesë ankimore anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë. Ankuesit parashtrojnë se KZAZ ka bërë plotësisht detyrën e saj duke emëruar numëruesit dhe ka njoftuar partitë politike për t'u paraqitur në numërim. Më pas, sipas ankuesit, është vullneti i partive për t'i mbajtur ata në tavolina.

Përfundimisht, anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë, kërkojnë shfuqizimin e vendimit nr. 318, datë 26.04.2021 i KSHZ-së.

9. Kundër vendimit nr. 313, datë 26.04.2021 të KSHZ-së kanë depozituar kërkesë ankimore anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 02, qarku Shkodër. Ankuesit parashtrojnë se puna për vijimin e numërimit ka qenë e pandërprerë por me ritme pak të ngadalta për shkak të lodhjes së madhe dhe procedurave të shumta që ka procesi në këto zgjedhje. Ankuesit sqarojnë se është punuar intensivisht edhe gjatë natës.

Përfundimisht, anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 02, qarku Shkodër, kërkojnë shfuqizimin e vendimit nr. 313, datë 26.04.2021 të KSHZ-së.

10. Kundër vendimit nr. 307, datë 26.04.2021 të KSHZ-së kanë depozituar kërkesë ankimore anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës. Ankuesit parashtrojnë se:

- Nuk ka asnjë shkelje në frymën e ligjit pasi janë realizuar cilësisht dhe me transparencë detyrat që ligji i ka ngarkuar KZAZ.
- Mos respektimi i afatit ka ardhur për shkaqe që nuk varen nga ne.
- Numri i madh i QV dhe kushtet e limituara të ambienteve për shtimin e GNV ka ngadalësuar procesin.
- Marrja në dorëzim kësaj here (këto zgjedhje) edhe e PEI zgjati përtej afatit të zakonshëm. Nga ana e KZAZ i është kushtuar vëmendje përmblyes cilësore të procesit dhe jo asaj sasiore në kohë, e cila mund të ndikonte negativisht në saktësinë e rezultatit.



- Lodhja nga pagjumësia ka ulur ndjeshëm rezistencën fizike dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në vonesat.

Përfundimisht, anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës, kërkojnë shfuqizimin e vendimit nr. 307, datë 26.04.2021 të KSHZ-së.

11. Kundër vendimit nr. 308, datë 26.04.2021 të KSHZ-së kanë depozituar kërkesë ankimore anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës. Ankuesit parashtrajnë se KZAZ në fjalë ka në administrim 108 QV të cilat janë në një distancë e largësi të konsiderueshme e cila varion nga 5 deri edhe 45 km nga VNV. Ky fakt ka ndikuar drejtpërdrejt në proces. Për këtë arsye, procesi i numërimit ka filluar në orën 03:00 të datës 26 prill dhe jo në orën 22 të datës 25 prill sikurse ishte parashikuar.

Përfundimisht, anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës, kërkojnë shfuqizimin e vendimit nr. 308, datë 26.04.2021 të KSHZ-së.

12. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 27, datë 30.04.2021 të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 66, qarku Berat;
- Kërkesën ankimore nr. 28, datë 30.04.2021 të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë;
- Kërkesën ankimore nr. 29, datë 30.04.2021 të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër;
- Kërkesën ankimore nr. 30, datë 30.04.2021 të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës;
- Kërkesën ankimore nr. 31, datë 30.04.2021 të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës;
- Vendimin nr. 306, datë 26.04.2021 të KSHZ;
- Vendimin nr. 318, datë 26.04.2021 të KSHZ.
- Vendimin nr. 313, datë 26.04.2021 të KSHZ;
- Vendimin nr. 307, datë 26.04.2021 të KSHZ;
- Vendimin nr. 308, datë 26.04.2021 të KSHZ;

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,



KAS-i konstatoi:

1. Në 25 Prill 2021, në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë në 12 zona zgjedhore. Pas mbylljes së procesit të votimit, në mbështetje të neneve 112 e vijues të Kodit Zgjedhor, që rregullojnë procesin e mbylljes dhe numërimit të votave, KZAZ-të marrin vendim për fillimin e numërimit të votave, pasi kanë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit nga të gjitha QV-të, nën juridiksionet e tyre përkatëse.
2. Në vendimet e tij nr. 306, nr. 318, nr. 313, nr. 307 dhe nr. 308 datë 26.04.2021, KSHZ-ja argumenton se KZAZ-të nr. 66, nr. 38, nr. 2, nr. 20 dhe nr. 21 kanë kryer kundërvajtje administrative duke mos përmbushur detyrimin për nxjerrjen e Tabelës Përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve sipas pikës 1, të nenit 122, të Kodit Zgjedhor për zonat e tyre përkatëse brenda orës 22:00 të datës 26.04.2021.

Neni 4, i ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” përcakton se: *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ligji parashikon dënim administrativ”*.

KSHZ nuk ka arritur të administrojë asnjë provë ose fakt të tilla si procesverbale, akte ose shkresa që të vërtetojnë shkeljen e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga ana e KZAZ-ve, duke u mjaftuar vetëm me faktin se KZAZ-të nuk nxorën Tabelën Përmbledhëse brenda orës 22:00 të datës 26.04.2021. Pra, nga ana e Komisionerit nuk është kryer asnjë lloj hetimi administrativ rast pas rasti për të përcaktuar qartësisht faktin nëse KZAZ-të e sipërpërmendura kanë patur përgjegjësi për shkeljen e kodit dhe moskryerjen e detyrave të tyre dhe në rast se kanë patur, cilën nga dispozitat konkrete kanë shkelur. Vetëm një proces hetimi administrativ i rasteve në fjalë, i cili do të ballafaqonte pretendimet e ngritura nga ankimesit me situatën faktike, do të bënte të mundur një vendimmarrje të qartë dhe objektive nga KSHZ dhe si të tillë të pacënueshme.

3. KAS vëren se nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor nga ana e KZAZ-së, kryhet vetëm pasi Grupet e Numërimit të Votave, në zbatim të nenit 119, pikave 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, plotësojnë tabelën e rezultateve sipas formularit tip të përcaktuar nga KQZ-ja dhe më pas ja dorëzojnë atë dorazi KZAZ-së. Numërimi i fletëve të votimit nuk është përgjegjësi e KZAZ-ve por e Grupeve të Numërimit të Votave. KZAZ-të nuk kanë patur mundësi objektive për të nxjerrë Tabelën Përmbledhëse të rezultatit zgjedhor, duke qenë se GNV-të ende nuk i kishin dorëzuar ato në orën 22:00. Nga vlerësimi i pretendimeve të ngritura në ankim dhe nga hetimi administrativ në tërësi i zhvilluar nga KAS,



rezulton se KZAZ-të nuk kanë patur mundësi objektive për të nxjerrë Tabelën Përmbledhëse të rezultatit zgjedhor, duke qenë se GNV-të ende nuk i kishin dorëzuar ato në orën 22:00.

Për më tepër, arsyetimi se “janë numëruar më pak se 50% e qendrave të votimit në KZAZ përkatëse” është i pambështetur në ligj dhe sjell pabarazi në raport me KZAZ e tjera. Për atë kohë sa Kodi Zgjedhor nuk parashikon një detyrim për numërim qendrash votimi për orë, dënimi administrativ për mosarritjen e një objektivi me përqindje është i pambështetur në ligj.

4. Për shkak edhe të ndryshimeve të fundit të Kodit Zgjedhor, ndryshe nga zgjedhjet e kaluara, në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 u ndoq një procedurë e dyfishtë e numërimit dhe vlerësimit të votave, bazuar në ndryshimet e nenit 118, pika 6 dhe 6/1 të Kodit Zgjedhor: fillimisht u krye numërimi i votave për subjektet zgjedhore dhe më pas numërimi i votave parapëlqyese për çdo kandidat të subjektit zgjedhor. Një procedurë e tillë e dyfishtë e numërimit të votave sjell vështirësi objektive për të përmbyllur procesin e numërimit në orën 22:00 të ditës pasardhëse të votimit.
5. Në vendimet e tij nr. 306, nr. 318, nr. 313, nr. 307 dhe nr. 308 datë 26.04.2021, KSHZ ka sanksionuar me gjobë përveç anëtarëve, edhe sekretarët e KZAZ-ve përkatëse. Detyrat e sekretarit të KZAZ-së janë të përcaktuara në nenin 34, të Kodit Zgjedhor, dhe në asnjë prej tyre nuk përmendet përgatitja dhe miratimi i tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve. Kjo detyrë përmendet në shkronjën “ë” të nenit 33 të Kodit ku përcaktohen detyrat e KZAZ-së. Ndarja e detyrave të sekretarit të KZAZ-së nga detyrat anëtarëve të KZAZ-së në dy nene të veçanta, përforcon faktin se sekretari nuk mund të mbajë përgjegjësi për shkeljet që mund të bëjnë anëtarët e KZAZ-së apo Grupi i Numërimit të Votave.
6. Po ashtu, vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk qëndron as sa i përket procedurës së ndjekur nga ky i fundit. Për shkeljet potenciale që mund të kryhen nga zyrtarët zgjedhorë, për parregullsi në administrimin e punës prej tyre, ose kur konstatohet moszbatimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor, neni 21, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të këtij Kodi parashikojnë kompetencën e KAS-it për të vlerësuar performancën e komisionerëve dhe numëruesve, si dhe për të vendosur masa disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë, me kërkesë të KSHZ-së. Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka çënuar kompetencën e KAS.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr.3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesave ankimore me nr. 27; nr. 28; nr. 29; nr. 30 dhe nr. 31 të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-së nr. 66, qarku Berat; KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë; KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër; KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës dhe KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës.
2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 306; nr. 318; nr. 313; nr. 307 dhe nr. 308, datë 26.04.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe heqjen e sanksionit administrativ ndaj anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-së nr. 66, qarku Berat; KZAZ-së nr. 38, qarku Tiranë; KZAZ-së nr. 2, qarku Shkodër; KZAZ-së nr. 20, qarku Durrës dhe KZAZ-së nr. 21, qarku Durrës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvis ÇEFA - Kryesues

Elvin LAKO - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

